

URDHËR
Nr. 201, datë 7.5.2024

PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 113, DATË 26.3.2024, “PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DHE CAKTIMIN E DETYRAVE TË ZËVENDËSMINISTRIT TË ARSIMIT DHE SPORTIT, ZNJ. ANA KAPAJ”, I NDRYSHUAR, DHE NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 10, DATË 15.1.2021, “PËR NGRITJEN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT (AKKSHI)”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 22 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të pikës 8, të nenit 12, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 113, datë 26.3.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar, pas shkronjës “sh”, të pikës 2, shtohet shkronja “t” me përmbajtje si më poshtë:

“t) kryesimin e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.”.

2. Në pikën 2, të urdhrit nr. 10, datë 15.1.2021, “Për ngritjen e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, të ndryshuar, kryesuesi i Bordit të Administrimit të jetë znj. Ana Kapaj, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

3. Ngarkohet zëvendësministri znj. Ana Kapaj, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, dhe Bordi i Administrimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu